

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT

Kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes

Për kurset e të rriturve pjesëmarrësi duhet të jetë të paktën 16 vjeç dhe për kurset e adoleshentëve të paktën 12 vjeç.

1. Regjistrimi dhe kushtet e pagesës

- 1.1. Rezervimi për çdo kurs, përfshi edhe kurset pasardhëse, duhet bërë 2 javë para fillimit të kursit dhe afati i fundit i regjistrimit (pagesa e plotë e tarifës së kursit) për çdo kurs duhet bërë 1 javë para fillimit të kursit.
- 1.2. Në rast se pagesa e plotë e tarifës së kursit nuk bëhet në kohë, kursanti humbet të drejtën e frekuentimit të kursit.
- 1.3. Tarifa e kursit mund të shlyhet me kartë krediti/debiti në zyrën e regjistrimit, ose me transfertë bankare.

2. Çmimet dhe kushtet e pagesës

- 2.1. Pjesë e marrëveshjes janë tarifën e vlefshme në momentin e regjistrimit në kurs, të cilat janë afishuar në faqen e internetit të Goethe-Zentrum.
- 2.2. Në tarifën e kursit nuk përfshihet çmimi i librave.
- 2.3. Nëse kursanti dëshiron të ndryshojë kursin (ndryshim datash ose kursit), ndryshimi i parë bëhet pa pagesë. Për çdo ndryshim tjetër mbahet një vlerë prej 10 % nga tarifa e kursit. Ndryshimi i kursit në një nivel tjetër, me rekomandimin e mësuesit përkatës, ose si rezultat i një testimi të mëvonshëm për përcaktimin e nivelit, bëhet pa pagesë shtesë.
- 2.4. Në rast regjistrimi të dy apo më shumë anëtarëve të së njëjtës familje (fëmijë, bashkëshortë, motra, vëllezër, prindër), Goethe-Zentrum ofron një zbritje prej 10 % për secilin nga anëtarët për kurset e përgjithshme.
- 2.5. Testi i përcaktimit të nivelit ofrohet pa pagesë shtesë.
- 2.6. Kursantët, të cilët në çastin e regjistrimit në një provim të Goethe-Institut janë të regjistruar edhe në një kurs aktual pranë qendrës sonë, përfitojnë zbritje në tarifën e provimit të Goethe-Zentrum. Kjo vlen vetëm për provimet e Goethe-Institut dhe përjashtohet si mundësi për provimet TestDaF dhe TestAS.

3. Çregjistrimi

- 3.1. Në rast se kursanti nuk mund të ndjekë kursin për të cilin është regjistruar, vlejnë kushtet e mëposhtme të çregjistrimit:
 - 3.1.1. Në rast çregjistrimi deri ditën e fundit të punës para fillimit të kursit, mbahet një tarifë administrative prej 10 % së tarifës së kursit.
 - 3.1.2. Në rast çregjistrimi nga dita e parë deri në ditën e tretë të kursit, mbahet një tarifë administrative prej 20 % së tarifës së kursit.
 - 3.1.3. Në rast çregjistrimi të mëvonshëm, kthimi i pagesës nuk është më i mundur, pavarësisht nëse kursi është ndjekur apo jo.
- 3.2. Njoftimi për çregjistrimin duhet paraqitur me shkrim. Si datë çregjistrimi vlen data e mbërritjes së njoftimit në Goethe-Zentrum.

4. Përcaktimi i nivelit

- 4.1. Përcaktimi i nivelit bëhet mbi bazën e një testi për njohuritë gjuhësore online. Për ish-kursantët ose personat që paraqesin certifikata të Goethe-Institut përcaktimi i nivelit mund të bëhet në bazë të dëshmisë së pjesëmarrjes në kurs ose të certifikatës së provimit, nëse data e lëshimit të tyre nuk e kalon 1 vit.
- 4.2. Kurset tona përbëhen minimalisht nga 8 dhe maksimalisht nga 16 pjesëmarrës. Në rast se në fillim të kursit numri i kursantëve është shumë i vogël (nën 8 persona), Goethe-Zentrum ruan të drejtat për ta anuluar këtë kurs ose të ndryshojë datën/orën e fillimit të tij. Në këtë rast, u ofrojmë kursantëve mundësinë e kalimit në një kurs tjetër ose të kthimit të tarifës së plotë të kursit.

5. Dëshmitë e pjesëmarrjes dhe certifikatat

- 5.1. Një dëshmi pjesëmarrjeje lëshohet vetëm nëse kursanti ka qenë i pranishëm në të paktën 75 % të totalit të orëve të mësimi.
- 5.2. Nëse kursanti vlerësohet në përfundim të kursit (pas 60 orëve mësimore) me notën "Vlerësimi: ka marrë pjesë", atëherë ai nuk kalon në kursin pasardhës. Megjithatë, ai gëzon të drejtën për të kryer testin e përcaktimit të nivelit, për rivlerësimin e njohurive të tija të gjuhës gjermane. Në rast se rezultati i testit dëshmon njohuri të mjaftueshme për të kaluar në kursin pasardhës, kursanti fiton të drejtën e kalimit në atë kurs.
- 5.3. Dëshmitë e pjesëmarrjes ruhen në Goethe-Zentrum deri në 1 vit. Koha maksimale e ruajtjes së dokumentacionit të provimeve është përcaktuar në Rregulloren e Provimeve të Goethe-Institut.
- 5.4. Lëshimi i një dublikate bëhet vetëm me pagesë: 1.500 lekë për një dëshmi pjesëmarrjeje kursi dhe 2.000 lekë për certifikatat e Goethe-Institut. Pas përfundimit të afatit maksimal për ruajtjen e dokumentacionit, lëshimi i një dublikate është i pamundur.

6. Ndërrimi i kursit

Në raste të veçanta, kursantët mund të ndërrojnë kursin e tyre brenda javës së parë të kursit, në marrëveshje me mësuesin/mësuesin, për aq kohë sa në kursin tjetër ka kapacitet të mjaftueshëm. Ndërrimi i kursit bëhet pa pagesë. Nëse në kursin e dëshiruar nuk ka më vende të lira, atëherë ndërrimi i kursit nuk është i mundur.

7. Pjesëmarrës me nevojë të veçanta fizike

Goethe-Zentrum përpiqet të gjejë në marrëveshje me personat me aftësi të kufizuara fizike një zgjidhje të pranueshme dhe të përshtatshme për të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me mësimdhënien.

8. Detyrimet e kursantit

Kursanti ka për detyrë të zbatojë kushtet e përgjithshme të biznesit të Goethe-Zentrum dhe rregulloren e provimeve.

9. Përgjegjësia e Goethe-Zentrum / forcat madhore

Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga kursantët apo pjesëmarrësve të provimit nga veprime të qëllimshme apo nga pakujdesia. Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për mosofrimin e shërbimeve të saja të ndikuara nga forcat madhore (p.sh. në rast katastrofash natyrore, zjarri, përmbytjesh, lufte, urdhri nga institucionet shtetërore dhe në të gjitha rrethanat e tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të palëve në marrëveshje). Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për sendet personale dhe me vlerë të kursantëve dhe të pjesëmarrësve të provimit.

10. Mbrojtja e të dhënave

Kursanti pranon që Goethe-Zentrum të ruajë elektronikisht të dhënat e tija të regjistrimit, të kontabilitetit dhe të vlerësimit. Kursanti bie dakord që të njoftohet nga Goethe-Zentrum rreth kurseve, aktiviteteve kulturore dhe shërbimeve të tjera të qendrës në mënyrë elektronike, me shkrim dhe/ose telefonike.

11. Kushtet e veçanta për kurset individuale

- 11.1. Numri minimal i orëve mësimore për një kurs individual është 10, me nga 2 orë mësimore për seancë (1 orë mësimore = 45 minuta).
- 11.2. Data dhe oraret përcaktohen në marrëveshje të ndërsjellë dhe me shkrim para fillimit të kursit. Sipas nevojës dhe me kërkesë të kursantit mund të zhvendosen 30 % të datave dhe/ose të orareve të kursit, pa pagesë shtesë.
- 11.3. Pagesa e kursit duhet të kryhet e plotë para fillimit të kursit.
- 11.4. Zhvendosja e dëshiruar e datës së zhvillimit të mësimi duhet të komunikohet të paktën 24 orë (jo në fundjavë dhe ditë festash) para zhvillimit të kursit. Në rast se njoftimi bëhet më vonë, orët e pazhvilluara të mësimi do të tarifohen me vlerën e plotë. Në raste aksidenti apo sëmundjesh akute kërkohet të paraqitet sa më shpejt të jetë e mundur një raport mjekësor.

- 11.5. Pas çdo seancë mësimore, kursanti duhet të nënshkruajë për seancën e zhvilluar.

Aktualizimi i fundit: 12.11.2025

GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER

